



STATUTI INDRYSHUAR

I

FONDACIONIT

“M. & M. IVANAJ FOUNDATION INSTITUT”

M. & M. Ivanaaj Foundation Institut

Tabela e Lëndës

HYRJE	4
NENI I. FORMA, EMRI, SIGLA DHE SIMBOLI	4
PARAGRAFI 1.01 FORMA DHE EMRI I ORGANIZATËS	4
PARAGRAFI 1.02 SIGLA E FONDACIONIT	4
PARAGRAFI 1.03 KORRESPONDENCIA	4
NENI II. SELIA	4
NENI III. SHTRIRJA TERRITORIALE	4
NENI IV. KOHËZGJATJA	4
NENI V. QËLLIMI I FONDACIONIT	5
PARAGRAFI 5.01 QËLLIMI I FONDACIONIT	5
PARAGRAFI 5.02 PAVARËSIA E FONDACIONIT	5
NENI VI. FUSHA E VEPRIMTARISË	5
NENI VII. NDALIMI I SHPËRNDARJES SË FITIMEVE	6
NENI VIII. BURIMET FINANCIARE	6
PARAGRAFI 8.01 PRONËSIA MBI PASURITË E FONDACIONIT	6
PARAGRAFI 8.02 BURIMET E TË ARDHURAVE	6
NENI IX. KRITERET E ADMINISTRIMIT TË PASURISË	6
PARAGRAFI 9.01 SHPENZIMET	6
PARAGRAFI 9.02 TE ARDHURAT	6
PARAGRAFI 9.03 DHURIMET	6
NENI X. ORGANET DREJTUESE TË FONDACIONIT	7
PARAGRAFI 10.01 ORGANET DREJTUESE	7
PARAGRAFI 10.02 ORGANE KËSHILLIMORE DHE TË TJERA	7
NENI XI. BORDI I DREJTORËVE	7
PARAGRAFI 11.01 KOMPETENCAT	7
PARAGRAFI 11.02 PËRBËRJA E BORDIT TË DREJTORËVE	7
PARAGRAFI 11.03 MBLEDHJA E BORDIT TË DREJTORËVE	7
PARAGRAFI 11.04 EMËRIMI, SHKARKIMI DHE NDRYSHIMI I ANËTARËVE TË BORDIT	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
PARAGRAFI 11.05 KARAKTERI VULLNETAR	9
PARAGRAFI 11.06 MARRËVESHJET E VEÇANTA DHE ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE	9
PARAGRAFI 11.07 NDRYSHIMI I STATUTIT DHE AKTIT TË THEMELIMIT	10
NENI XII. DREJTORI EKZEKUTIV	10
PARAGRAFI 12.01 KOMPETENCAT	10
PARAGRAFI 12.02 PËRFFAQËSIMI LIGJOR	10
PARAGRAFI 12.03 ADMINISTRATA	10
NENI XIII. PËRGJEGJËSIA E ANËTARËVE TË ORGANEVE DREJTUESE DHE PUNONJËSVE	11

NENI XIV. VITI FINANCIAR.....	11
NENI XV. MARRËDHËNIET E PUNËS	11
NENI XVI. BASHKIMI DHE NDARJA.....	11
NENI XVII. SHPËRNDARJA E FONDACIONIT	11
PARAGRAFI 17.01 SHPËRNDARJA NË RAST TË KRIJIMIT TË FONDACIONIT TESTAMENTAR	11
PARAGRAFI 17.02 SHPËRNDARJA ME VENDIM TË GJYKATËS.....	12
PARAGRAFI 17.03 SHPËRNDARJA NË RASTE TË TJERA	12
PARAGRAFI 17.04 LIKUIDATORI	12
NENI XVIII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE	12

STATUTI I NDRYSHUAR
I
FONDACIONIT
“M. & M. IVANAJ FOUNDATION INSTITUT”

HYRJE

Fondacioni “M. & M. IVANAJ FOUNDATION INSTITUT” është një person juridik shqiptar i regjistruar më vendimin nr. 8229, datë 10.10.1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë (“Fondacioni”), themeluar nga Znj. Drita Ivanaj, lindur më 15.06.1933, shtetase amerikane, me banim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës: Cherokee Station POBOX 20661, NEW YORK 10021-0073, me pasaportë nr. 512279599, e cila në këtë statut do i referohemi si “Themeluesja”.

Bazuar në faktin se, statuti i Fondacionit ka disa ndryshime që konsiderohen të nevojshme, bordi drejtues i përbërë nga Drita Ivanaj, Perteve Leka, Diana Shehu, Ani Rizo, Afërdita Prroni, Dhimitraq Rizo dhe Frost & Fire Consulting (duke përfshirë dhe ndryshimet që mund të ndodhin në anëtarësinë e tij në bazë të këtij Statuti, në vijim “Bordi i Drejtoreve”) më datë [●], bëri miratimin e Statutit të Ndryshuar të Fondacionit “M. & M. IVANAJ FOUNDATION INSTITUT”, (“Statuti”) i cili përbëhet nga nenet e mëposhtme:

NENI I. FORMA, EMRI, SIGLA DHE SIMBOLI

Paragrafi 1.01 Forma dhe Emri i Organizatës

Forma e kësaj organizate joftimprurëse është “Fondacion” me emrin: “M. & M. IVANAJ FOUNDATION INSTITUT”.

Paragrafi 1.02 Sigla e Fondacionit

Sigla e Fondacionit bashkë me simbolin e tij të veçantë është paraqitur në një fletë pjesë përbërëse të këtij Statuti. Sigla dhe simbolet e Fondacionit mund të ndryshohen me vendim të Bordit të Drejtoreve.

Paragrafi 1.03 Korrespondencia

Emri dhe sigla e Fondacionit duhet të figurojnë në të gjitha shkresat dhe korrespondencën që del nga Fondacioni.

NENI II. SELIA

Selia e Fondacionit ndodhet në Tirane, ne adresen Bulevardi Gjergj Fishta, Qendra “Alpas”, ish parku Spedicionit, katë II, apt 2 Tiranë. Selia mund të ndryshohet me vendim të Bordit të Drejtoreve.

NENI III. SHTRIRJA TERRITORIALE

Fondacioni zhvillon aktivitetin e tij pa kufizim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Ai mund të themelojë degë të tij, apo te hapë zyra përfaqesimi në çdo njësi administrativo-territoriale të Shqipërisë apo edhe jashtë territorit të Shqipërisë.

NENI IV. KOHËZGJATJA

Fondacioni themelohet dhe do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohe të pacaktuar.

NENI V. QËLLIMI I FONDACIONIT

Paragrafi 5.01 Qëllimi i Fondacionit

Qëllimi i Fondacionit është të kryejë veprimitari në të mirë dhe interes të publikut, përfshirë, por pa u kufizuar në:

- a) Të nxise dhe të inkurajojë interesin e publikut të gjerë për kulturën dhe arsimin shqiptar, brenda dhe jashtë vendit;
- b) Të inkurajojë përhapjen dhe shpërndarjen e njoħurive për traditat e Shqipërisë në fushën shkencore, juridike dhe intelektuale;
- c) Të inkurajojë edukimin e njerëzve për historinë e Shqipërisë – dhe të ndihmojë për t'a dokumentuar atë për brezat që do të vijnë;
- d) Të përhapë informacion dhe njoħuri për Shqipërinë në botë;
- e) Të ndihmojë zhvillimin e talenteve dhe shpirtit inovator të rinisë shqiptare; si dhe
- f) Të ndihmojë në zhvillimin e bizneseve inovatore që synojnë zhvillimin e ekonomisë shqiptare; si dhe
- g) te kryeje cdo aktivitet tjeter qe nuk eshte i ndaluar ne menyre te shprehur nga legjislacioni shqiptar apo ky Statut, per arritjen e qellimit të Fondacionit.

Paragrafi 5.02 Pavarësia e Fondacionit

Fondacioni është i pavarur dhe nuk ka lidhje me asnjë organizatë politike, fetare ose etnike.

NENI VI. FUSHA E VEPRIMTARISË

Aktivitetet dhe programet kryesore të këtij Fondacioni janë të lidhura me:

- a) Organizimin dhe katalogimin e dokumenteve historike të dhuruara nga familja Ivanaj;
- b) Ekspozimin e dokumenteve historike dhe ligjore të dhuruara nga familja Ivanaj dhe familjet e tjera me prejardhje shqiptare nëpër botë;
- c) Përkhimin dhe botimin e dorëshkrimeve dhe letrave të tjera historike që kanë të bëjnë me familjen Ivanaj;
- d) Planifikimin, hartimin dhe realizimin e propozimeve për mundësimin e bursave të studimit, për studime që kanë të bëjnë me fushën kulturore, shkencore, juridike dhe intelektuale shqiptare;
- e) Krijimin e programeve kompjuterike për kryerjen e aktiviteteve të mësipërme;
- f) Nxitjen e rrujtjes dhe zhvillimit të traditave kulturore shqiptare;
- g) Rritjen e vetëdijes rreth nevojave të arsimimit dhe shkollimit të të rinjve shqiptarë;
- h) Koordinimin dhe vendosjen e programeve me institucionet akademike dhe organizatat e biznesit për edukimin e publikut shqiptar rreth historisë së Shqipërisë dhe shqiptarëve;
- i) Zhvillimin e programeve për tritjen e interesit të komuniteteve shqiptare dhe diasporave në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në mbarë botën për Shqipërinë dhe trojet shqiptare;
- j) Zhvillimin e programeve që ndihmojnë inovacionin dhe mendjen krijuese të rinisë shqiptare; si dhe
- k) Zhvillimin e programeve që ndihmojnë bizneset e vogla.

NENI VII. NDALIMI I SHPËRNDARJES SË FITIMEVE

Ndalohet çdo formë e shpërndarjes së fitimit ose përsitimit financiar dhe material nga pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e Fondacionit nga Bordi i Drejtoreve apo stafi ekzekutiv i Fondacionit, përvëç detyri me në formën e pagave, rrogave, pagesave, shpërblimeve e kompësimeve që rrjedhin nga kontrata e punës dhe kontrata të tjera të ngjashme ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të Fondacionit, apo shpenzimë të kryera nga anëtarët e e Bordit të Drejtoreve (sic është përkufizuar në nenin XI më poshtë) për veprimtari në sherbim dhe për llogari të Fondacionit.

NENI VIII. BURIMET FINANCIARE

Parografi 8.01 Pronësia mbi Pasuritë e Fondacionit

Fondacioni mund të ketë në pronësi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, te mira materiale dhe jomateriale, pronësi intelektuale, të drejta autori dhe të drejta të tjera të lidhura me të, si dhe cdo, pasuri apo të drejtë tjetër të lejuar nga ligji.

Parografi 8.02 Burimet e të Ardhurave

Burimet e të ardhurave të Fondacionit mund të janë:

- Ndihmat dhe dhurimet që mund të sigurojnë për Fondacionin Themeluesja dhe/ose anëtarët e organeve drejtuese;
- Ndihmat e të gjitha llojeve dhe dhuratave që do të përsitohen nga "The Martin and Mirash Ivanaj Foundation" e cila është një organizatë jo fitimprurëse e regjistruar në vitin 1995 në shtetin e New York, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe nga organizatat jo fitimprurëse të huaja, individë të ndryshëm dhe shtete;
- Të ardhurat që mund vijnë nga kontributet e dhëna prej individëve të ndryshëm si rezultat i pjesëmarrjes në aktivitete që do të zhvillojë Fondacioni;
- Të ardhurat që mund të vijnë nga administrimi i pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të Fondacionit; si dhe
- Veprimtari të tjera ekonomike të lejuara nga ligji.

NENI IX. KRITERET E ADMINISTRIMIT TË PASURISË

Parografi 9.01 Shpenzimet

Fondacioni bën shpenzimet vetëm për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë për të cilin është krijuar si dhe për drejtimin e mirëmbajtjen e pasurisë së tij.

Parografi 9.02 Te ardhurat

Të gjitha të ardhurat që Fondacioni fiton nëpërmjet veprimtarisë së tij ekonomike përdoren vetëm për përbushjen e qëllimeve të përcaktuara në këtë Statut dhe në Aktin e Themelimit.

Parografi 9.03 Dhurimet



Fondet financiare ose te mira te tjera materiale të dhuruara nga donatorë të ndryshëm me destinacion përdorimi të përcaktuar duhet të përdoren pa ndryshuar destinacionin e tyre me përjashtim të rasteve kur kjo është e pamundur apo kur është dhënë miratimi nga vetë donatorët. Marrëdhëniet e Fondacionit me donatorët realizohen në përputhje me marrëveshjet përkatëse.

NENI X. ORGANET DREJTUESE TË FONDACIONIT

Paragrafi 10.01 Organet Drejtuese

Organet Drejtuese të Fondacionit janë:

- Bordi i Drejtorëve
- Drejtori Ekzekutiv

Paragrafi 10.02 Organe Këshillimore dhe të Tjera

Fondacioni mund të krijojë dhe organe të tjera këshillimore si Bordi i Anëtarëve të Nderit apo komitete të ndryshme për mbarëvajtjen e oragnizimit të Fondacionit.

NENI XI. BORDI I DREJTORËVE

Paragrafi 11.01 Kompetencat

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë vendimmarrës i Fondacionit. Ai përveç çështjeve të përcaktuara nga ligji që duhet të shqyrtohen prej tij, vndos për:

- a) ndryshimin e Statutit dhe të Aktit të Themelimit dhe rregullave të tjera të brendshme;
- b) transformimin, ndarjen ose bashkimin e Fondacionit me fondacione të tjera;
- c) përcakton fushat dhe programet e veprimitarisë, kërkon dhe kontrollon rregullisht realizimin e tyre;
- d) shqyrtzon çështjet ekonomike, financiare dhe të administrimit, miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e Fondacionit dhe shpenzimet për vitin në vazhdim, perfshire pagat e punonjesve te Fondacionit;
- e) nxjerr norma përrregullimin e veprimitarisë, të organizimit dhe të strukturës së organizatës;
- f) emëron dhe shkarkon anëtarët e Bordit të Drejtorëve;
- g) emëron dhe shkarkon Drejtorin Ekzekutiv, i cakton atij pagën dhe kontrollon realizimin e detyrave dhe veprimitarisë së tij,
- h) krijon komitete të posaçme, krijon organizma të tjera këshillimore;
- i) autorizon direkt persona për të kryer detyra të caktuara;
- j) ne përputhje me këtë Statut, vndos përvetshpërndarjen e Fondacionit dhe destinacionin e pasurisë së mbetur, si dhe për çdo çështje tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj; si dhe
- k) vndos përshtblerjen dhe/ose transferimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të Fondacionit.

Paragrafi 11.02 Përbërja e Bordit të Drejtorëve

Bordi i Drejtorëve përbehet nga jo më pak se tre anëtarë deri në një numër të pakufizuar anëtarësh. Anëtarët qëndrojnë në këtë detyre pa asfat. Anëtarët shkarkohen kur doherë vetëm sipas rasteve dhe mënyrave të përcaktuara në Statut. Anetare te Bordit te Drejtoreve mund te jene individe apo persona juridik. Keta te fundit, duhet te zgjedhin një individ per ti perfaqesuar ne mbledhjet e Bordit te Drejtoreve. Me vendim të Bordit të Drejtorëve nje apo disa nga anetaret e Bordit te Drejtoreve marrin statusin e "Drejtorit te Veçante".

Paragrafi 11.03 Mbledhja e Bordit të Drejtorëve

a) Numri i Mbledhjeve. Bordi i Drejtorëve mblidhet të paktën një herë në vit por mund të mblidhet dhe më shumë se një herë kur kjo kërkonit nga 1/3 e anëtarëve të bordit ose nga Kryetari i Bordit për raste emergjente.

b) Kuorumi. Mbledhja e Bordit të Drejtorëve është e vlefshme me pjesëmarrjen e më shumë se gjysmës së anëtarëve të tij por vetëm nëse (i) Themeluesja është e pranishme për sa kohë ajo është gjallë dhe ka zotësinë juridike për të vepruar, ose (ii) nëse Themeluesja nuk është gjallë apo nëse ka humbur zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjyqësor, Drejtorët e Veçantë janë të pranishëm.

c) Vendimet e Bordit. Të gjitha vendimet e Bordit të Drejtorëve merren me 2/3 e numrit të anëtarëve të pranishëm për sa kohë që (i) Themeluesja është e pranishme dhe ka votuar pro ose (ii) nëse Themeluesja nuk është gjallë apo nëse ka humbur zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjyqësor, Drejtorët e Veçantë janë të pranishëm dhe të gjithë kanë votuar pro. Janë të pavlefshme vendimet e Bordit të Drejtorëve që merren (i) pa praninë e Themelueses dhe pa votën pro të saj ose (ii) në mungesë të Themelueses, pa praninë e Drejtorëve të Veçantë dhe votën pro të tyre. Çdo anëtar i Bordit të Drejtorëve ka të drejtën e vetëm të një vote.

d) Kryetari i Bordit. Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Bordit i cili zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve. Ai qëndron në detyrë për 5 vjet dhe është i rizgjedhshëm. Kompetencat e Kryetarit të bordit kufizohen vetëm për organizimin e mbledhjeve, thirrjen, drejtimin dhe mbarëvajtjen e saj. Në rastet kur Kryetari i Bordit nuk është prezent në mbledhje ai zëvendësohet përkohësisht nga një anëtar tjeter i bordit i zgjedhur nga bordi për këtë qëllim.

e) Njoftimet. Thirrja e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve bëhet me shkrim ose në mënyrë elektronike jo më vonë se dy javë nga dita e mbledhjes. Njoftimi dërgohet në adresën e deklaruar në selinë e Fondacionit nga secili anëtar. Ftesa duhet të përmbajë dhe rendin e ditës së mbledhjes. Mosmarrja e njoftimit për shkak të ndryshimit të adresës është përgjegjësi e vetë anëtarit. Mbledhja zhvillohet edhe kur nuk është respektuar afati i njoftimit me kusht që prezent në mbledhje të jenë të gjithë anëtarët që e përbëjnë bordin. Anëtarët që për shkaqe të arsyeshme nuk mund të marrin pjesë në mbledhje detyrohen të njoftojnë Kryetarin e Bordit jo më vonë se 5 ditë para datës së mbledhjes. Në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve lejohet përfaqësimi me prokurë i një anëtarë nga një anëtar tjeter i bordit apo nga persona të tjera të autorizuar prej tij, kur anëtarë i cili kërkon të përfaqesohet e ka lejuar këtë shprehimisht dhe me vullnetin e tij të lirë ka përcaktuar karakterin dhe vëllimin e tagreve që i ka dhënë përfaqësuesit të tij.

f) Proces-verbalı. Proces-verbalı i mbledhjes mbahet nga njëri prej anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, apo nga një person tjeter i caktuar per këtë qëllim nga Bordi i Drejtoreve. Ne rast se Bordi i Drejtoreve nuk ka emeruar person tjeter per te mbajtur proces - verbalin, kjo detyrë bëhet me qarkullim

ndërmjet anëtarëve. Proces-verbalet e mbledhjes dhe vendimet e Bordit të Drejtorëve duhet të mbahen në regjistrat përkatës dhe me rregull kronologjik dhe në fund proves-verballi firmoset nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës ndërsa vendimi i zbardhur nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve dhe personi që e ka mbajtur atë.

Paragrafi 11.04 Emërimi, Shkarkimi dhe Ndryshtimi i Anëtarëve të Bordit

a) Emërimi. Emërimi i anëtarëve të rinj të Bordit të Drejtorëve bëhet nga vetë Bordi i Drejtorëve ekzistues. Emërimi bëhet pas kërkesës së paraqitur nga vetë kandidati e cila shqyrtohet në mbledhjen më të afërt të bordit.

b) Shkarkimi. Shkarkimi i anëtarit bëhet nga mbledhja më e afërt e Bordit të Drejtorëve, kur anëtari i bordit:

- (i) kryen me dashje veprime në dëm të Fondacionit;
- (ii) nuk respekton rregullat për pjesëmarrjen në mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;
- (iii) shkel Statutin, Aktin e Themelimit apo rregulloret e Fondacionit; si dhe
- (iv) shpallet fajtor me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi.

Anëtari i propozuar për shkarkim nuk merr pjesë në votim por ka të drejtë të dëgjohet dhe të mbrojë veten e tij vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor, përpara Bordit të Drejtorëve.

Pavarësisht ndonjë dispozite në Statut, Akt Themelimi, apo ndonjë rregullore të Fondacionit që mund të bjerë ndesh me sa vijon, Bordi i Drejtorëve nuk mund të shkarkojë Themeluesen. Gjithashtu, nëse anëtari i propozuar për shkarkim është një nga Drejtorët e Veçantë, atëherë ai/ajo nuk mund të shkarkohet pa votën pro të Drejtorëve të Veçantë të tjera.

c) Ndryshimi. Ndryshtimi i anëtarit bëhet nga mbledhja më të afërt e Bordit të Drejtorëve, kur anëtari i bordit:

- (i) jep dorëheqjen;
- (ii) kur pushon së ekzistuari si person juridik, (nëse është i tillë); apo
- (iii) vdes apo humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim të gjykatës.

d) Zëvendësimi i Drejtorëve të Veçantë. Pavarësisht ndonjë dispozite në Statut, Akt Themelimi, apo ndonjë rregullore te Fondacionit që mund të bjerë ndesh me sa vijon, kur anëtari që duhet të zëvendësohet është një nga Drejtorët e Veçantë, atëherë kandidatët për ta zëvendësuar mund të propozohen nga çdo anëtar i Bordit të Drejtorëve, me kusht që kandidati nuk mund të zgjidhet në bord pa miratimin e Themelueses (nëse është gjallë) apo të Drejtorëve të Tjerë të veçantë (nëse Themeluesja nuk është gjallë apo nëse ka humbur zotësinë juridike për të vepruar me vendim të gjykatës). Pas miratimit, anëtari i zgjedhur për të zëvendësuar Drejtorin e Veçantë merr gjithashtu statusin e Drejtorit të Veçantë.

e) Përgjegjësia e Anëtarit të Languar. Përgjegjësia e anëtarit të Bordit të Drejtorëve që largohet është e njëjtë me atë të anëtarëve të tjera për veprimtarinë e tij të kryer deri në çastin e largimit.

Paragrafi 11.05 Karakteri Vullnetar

Anëtarët e Bordit të Drejtorëve në të gjitha rastet ushtrojnë funksionin e tyre në mënyrë vullnetare dhe pa kundërshperblim, përvçe se për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të

Fondacionit, apo shpenzime te tjera te kryera nga anëtarët e Bordit të Drejtorëve per veprimitari ne sherbim dhe për llogari të Fondacionit. Punonjësit e paguar nga Fondacioni nuk mund të janë njëkohesish anëtarë të Bordit të Drejtorëve. Ata mund të ftohen te marrin pjesë në mbledhjet e tij pa të drejtë vote.

Paragrafi 11.06 Marrëveshjet e Veçanta dhe Zgjidhja e Konflikteve

Marrëveshjet ndërmjet Fondacionit dhe një anëtarë të Bordit të Drejtorëve, Drejtorit Ekzekutiv dhe një punonjësi të saj, lejohen vetëm nëse: a) lidhen per të përbushur një qëllim të Fondacionit; b) janë të drejta; dhe c) janë në përputhje me vlerën e tregut. Marrëveshjet duhet të autorizohet paraprakisht nga Bordi i Drejtorëve dhe te miratohet nga ky i fundit pas firmosjes se saj, per te qene efektive. Personi i interesuar përashtohet nga votimi. Në raste marrëveshjesh të ndaluara kur kushtet kumulative të mësipërme nuk janë zbatuar, marreveshja eshte e pavlefshme dhe nuk sjell asnjë pasoje per Fondacionin, perveç rasteve kur Bordi i Drejtorëve ka pranuar me vone vlefshmerine e saj.

Paragrafi 11.07 Ndryshimi i Statutit dhe Aktit të Themelimit

Organi kompetent për ndryshimin e Statutit është Bordi i Drejtorëve. Ndryshimet mund të propozohen nga anëtaret e bordit apo Drejtori Ekzekutiv. Propozimet paraqiten me shkrim shoqëruar dhe me argumentet përkatese dhe u dërgohen jo më vonë se 30 ditë përpëra ditës së mbledhjes së Bordit të Drejtorëve. Vendimi për ndryshimin e Statutit dhe të Aktit të Themelimit merret në përputhje me Paragafin 11.03(c)(Vendimet e Bordit të Drejtorëve). E njëjtë procedurë ndiqet për miratimin apo ndryshimin e rregulloreve të brendshme.

NENI XII. DREJTORI EKZEKUTIV

Paragrafi 12.01 Kompetencat

- a) Drejtori Ekzekutiv merret me veprimtarinë e përditshme dhe ekzekutimin e programeve të vendosura nga Bordi i Drejtorëve;
- b) Ai kryen veprime bankare me llogarinë e Fondacionit, lidh dhe nënshkruan marrëveshje dhe kontrata në emër të Fondacionit në perputhje me vendimet dhe miratimin e Bordit të Drejtorëve;
- c) Emëron, shkarkon dhe ngarkon me detyra brenda funksionit punonjësit e administratës së Fondacionit (kur ka të tillë) dhe kontrollon zbatimin e tyre, merr persona në punë sipas vendeve vakante të përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve;
- d) Kontrollon mbarëvajtjen administrative të Fondacionit dhe harton lidhur me të raporte të hollësishme të cilat ia paraqet Bordit të Drejtorëve çdo 6 muaj ose më shpesh kur i kërcohët nga bordi, në mbledhjen vjetore të bordit ai paraqet raportin përfundimtar vjetor dhe atë financiar;
- e) Informon Kryetarin e Bordit të Drejtorëve për çështjet që vlerëson se duhet t' i paraqiten Bordit të Drejtorëve, përfshi dhe ato që kanë të bëjnë me ndryshimin e Statutit, Aktit të Themelimit, rregullores, harton projekte të reja, lidhur me aktivitetin e Fondacionit dhe ia paraqet për miratim Bordit të Drejtorëve, në raste urgjente, merr masat e domosdoshme dhe menjëherë informon Bordin e Drejtorëve;
- f) Drejtori Ekzekutiv merr pjesë në të gjitha mbledhjet e Bordit të Drejtorëve, por pa të drejtë vote.
- g) Drejtori Ekzekutiv mban përgjegjësi para Bordit të Drejtorëve për të gjithë veprimtarinë që kryen në funksionin dhe detyrat e tij.

Paragrafi 12.02 Përfaqësimi Ligjor



Drejtori Ekzekutiv, brenda kufizimeve te dhena ne kete Statut apo vendimeve te Bordit te Drejtoreve, është përfaqësuesi ligjor i Fondacionit me të tretët. Ai përfaqëson Fondacionin në marrëdhëniet me personat juridikë ose fizikë, vendas dhe të huaj, Institucionet Shtetërore në të gjitha llojet e marrëdhënieve juridike që Fondacioni lidh me to. Ai përfaqëson Fondacionin dhe në proceset gjyqësore kur Fondacioni është palë në gjykim dhe sipas rastit cakton një avokat për ndjekjen e çështjeve.

Paragrafi 12.03 Administrata

Administrata e Fondacionit drejtuhet nga Drejtori Ekzekutiv. Organizimi bazë i Strukturës së Administratës mund të propozohet nga Drejtorit Ekzekutiv dhe duhet të miratohet nga Bordi i Drejtoreve.

NENI XIII. PËRGJEGJËSIA E ANËTARËVE TË ORGANeve DREJTUESE DHE PUNONJËSVE

Anëtarët e Bordit të Drejtoreve, Drejtori Ekzekutiv dhe punonjësit e Fondacionit përgjigjen për detyrimet e Fondacionit ndaj të tretëve vetëm në rastet kur gjatë ushtrimit të detyrës, me dashje ose nga pakujdesia e rëndë i kanë shkaktuar dëm të tretëve.

NENI XIV. VITI FINANCIAR

Viti finanziar i Fondacionit është viti kalendarik nga 1 Janari deri në 31 Dhjetor. Bilanci duhet të përfundohet brenda 3 muajit të parë të vitit pasardhës.

NENI XV. MARRËDHËNIET E PUNËS

Marrëdhëniet e punës së Fondacionit rregullohen konform dispozitave të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

NENI XVI. BASHKIMI DHE NDARJA

Fondacioni mund të transformohet, ndahet ose bashkohet me fondacione të tjera sipas kushteve dhe mundësive që parashikon ligji dhe vendimeve të Bordit të Drejtoreve.

NENI XVII. SHPËRNDARJA E FONDACIONIT

Paragrafi 17.01 Shpërndarja në Rast të Krijimit të Fondacionit Testamentar

a) Krijimi i Fondacionit Testamentar. Fondacioni merr parasysh që Themeluesja e tij ka për qëllim kryesor që Fondacioni të vazhdojë të përbushë misionin e tij të pandryshuar në përfjetësi. Në mënyrë që kjo të realizohet, në përputhje me Nenin 18 të Ligjit nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” (ndryshuar sipas ligjit Nr. 92/2013), Themeluesja do të themelojë me anë të aktit testamentar një fondacion që do ketë të njëjtat objektiva, mision dhe qëllime si Fondacioni (sipas draft-statutit bashkangjitur si Shtojca 1 (në vijim, “Fondacioni Testamentar”).

b) Kalimi i Aseteve të Fondacionit te Fondacioni Testamentar. Në momentin kur Themeluesja do ketë ndërruar jetë dhe Fondacioni Testamentar do të jetë regjistruar në gjykatë, të gjitha asetet, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, materiale dhe jomateriale, pronësi intelektuale, të drejta autori dhe të drejta të tjera të lidhura me të, si dhe cdo pronësi, pasuri apo e drejtë tjetër e lejuar nga ligji (në vijim “Asetet e Fondacionit”) do ti kalojne Fondacioni Testamentar pa shpërblim. Ky Statut dhe ne vecant kjo dispozitë konsiderohet si një akt i mjaftueshem i vullentit të Bordit të Drejtoreve per te bërë kalimin e pershkruar me sipër si dhe ka formën e nevojshme juridike per te mundesuar kete kalim. Sidoqoftë, Fondacioni per te

lethesuar kalimin, duhet te ndermarre te gjitha veprimit si dhe te firmose te gjitha aktet që mund të konsiderohen të domosdoshme në kohën kur duhet të kryer kalimi. Pasi Fondacioni të jetë realizuar kalimi i Aseteve te Fondacionit tek Fondacioni Testamentar, Fondacioni do të vetëshpërndahet dhe kryejë çregjistrimin nga gjykata.

Paragrafi 17.02 Shpërndarja me Vendim të Gjykatës

Sipas rasteve dhe mënyrës së parashikuar në ligj, Gjykata mund të vendosë shpërndarjen e Fondacionit. Në këtë rast të gjitha kompetencat që ka Bordi i Drejtorëve kur vetshpërndahet i kalojnë Gjykatës sipas procedurës së përcaktuar në ligj.

Paragrafi 17.03 Shpërndarja në Raste të Tjera

Qëllimi i Themelueses dhe anëtarëve të Bordit të Drejtorëve është që, në mungesë të krijimit dhe regjistrimit të Fondacionit Testamentar, Fondacioni të vazhdojë veprimtarinë e tij përjetësisht. Në rast se Fondacioni Testamentar nuk krijohet dhe regjistrohet nga Gjykata për çfarëdo arsy, atëherë Fondacioni do të vazhdojë ti mbajë në zotërim Asetet e Fondacionit dhe do të vijojë veprimtarinë e tij në mënyrë normale në përputhje me nenet e tjera të këtij Statuti.

Gjithsesi, në rast se Fondacioni Testamentar nuk është regjistruar dhe Fondacionit do t'i duhet të shpërndahet për raste të paparashikuara në Statut apo në legjislacionin përkatës të kohës, Bordi i Drejtorëve në vendimin për shpërndarjen do të përcaktojë që Asetet e Fondacionit t'i kalojnë në radhë të parë : (i) organizatës jofitimiprurëse të filializuar në New York me emër "*The Martin and Mirash Ivanaj Foundation*" dhe (ii) në rast se organizata "*The Martin and Mirash Ivanaj Foundation*" ka pushuar së ekzistuari në atë kohë, Bordi i Drejtorëve do të përcaktojë emrat e organizatave jofitimiprurëse të cilave do t'u kalojë pasuria e mbetur si dhe pjesën takuese të secilës, duke pasur për bazë që këto organizata të kenë objektiva të ngashëm apo të afërt me Fondacionin.


Paragrafi 17.04 Likuidatori

Në rast se Fondacioni duhet të shpërndahet sipas 17.03 më lart (Shpërndarja në Raste të Tjera), Bordi i Drejtorëve cakton dhe një apo disa persona si Likuidatorë për të bërë dhurimin e pasurisë. Likuidatorët në të gjitha rastet kanë autoritetin dhe përgjegjësinë mbi asetat, pasurinë dhe përfaqësimin e Fondacionit që nga diita e emërimit të tyre deri në përfundim të procesit të dhurimit. Likuidatorët veç të tjerash vlerësojnë pasurinë e mbetur dhe kujdesen që ajo të shkojë në destinacionin e përcaktuar nga Statuti, Gjykata ose ligji. Raporti Përfundimtar i përgatitur nga Likuidatorët miratohet nga Bordi i Drejtorëve dhe më pas ky i fundit kërkon çregjistrimin e Fondacionit në Gjykatë. Kur Bordi i Drejtorëve refuzon miratimin e raportit përfundimtar, çështja zgjidhet nga Gjykata.

NENI XVIII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE


Përsa nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohen, dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë në fuqi dhe ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimiprurëse", të ndryshuar.

Statuti i ndryshuar më datë 10 – nentor 2015, miratohet dhe nënshkruhet nga Bordi i Drejtorëve i përbërë nga Drita Ivanaj, Diana Shehu, Ani Rizo, Aferdita Prroni. Duke filluar nga momenti i regjistrimit në gjykatë, ky Statut zëvendëson plotësisht Statutin e mëparshëm.



Për Fondacionin
“M. & M. IVANAJ FOUNDATION INSTITUT”

Drita Ivanaj Ani Rizo Diana Shehu Aferdita Prroni



The image shows four handwritten signatures in black ink. From left to right: 1) 'Drita Ivanaj' with a small circular emblem below it containing a stylized letter 'I'. 2) 'Ani Rizo' with a small circular emblem below it containing a stylized letter 'R'. 3) 'Diana Shehu' with a small circular emblem below it containing a stylized letter 'S'. 4) 'Aferdita Prroni' with a small circular emblem below it containing a stylized letter 'P'. The signatures are fluid and personal.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
N. 2311 Rep.
N. 528 Kol.

(2)

VERTETIM

Sot me daten 12.12.2015 (pesembedhjete), u prezantuan ne zyren noteriale, Rruga Ismail Qemali, P. 27/1, Tirane, zonjat Drita Ivanaj, n. personal D35615030P, Diana Shehu, n. personal E66016032B, Ani Rizo, n. personal G05509159F dhe Aferdita Prroni, n. personal H56120129P, si neneshkrues te Statutit te Fondacionit "M & M Ivanaj Foundation Institute", te panjohur prej meje por qe per identitetin e te cileve u sigurova nga dokumentat perkatese te identifikimit, madhore e me zotesi per te vepruar. Ato deklaruan se kete dokument e kane perpiluar me deshiren e tyre te plete dhe mbasi ju lexua permbytja e aktit e me vullnetin e tyre te lire firmosin para meje Noterit. Bere ne kater kopje.

NOTERI

Agim XH. ROBO

